



C.nr.471/12

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm-
Divizioni Civil gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Donjeta Elezi, në çështjen
juridike të paditëses [REDACTED] [REDACTED] të cilën e
përfaqëson [REDACTED] me autorizim, kundër të paditurit, [REDACTED] nga fshati
[REDACTED] Komuna Ferizaj për pagimin e borxhit, vlera e kontestit 6.667,36 €, pas
seancës publike të mbajtur më 25.08.2015, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe
në mungesë të të paditurit mori këtë:

AKT GJYKIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesë padia e paditëses, [REDACTED]
[REDACTED]

DETYROHET i padituri [REDACTED] që paditëses t'i paguajë shumën prej
6.667,36 €, në emër të borxhit të cilin e ka krijuar me rastin e shpenzimit të energjisë
elektrike, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 70 €, të gjitha në
afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

Arsyetim

Paditësja, [REDACTED] [REDACTED], në këtë
Gjykatë me dt.17.07.2012, ka ushtruar propozim për përmbarim ndaj të paditurit si
debitor për pagesën e borxhit në lartësi prej 6.667,36 €, në bazë të dokumentit autentik
faturën nr.DFE [REDACTED], të dt.20.05.2012.

Kjo Gjykatë me aktvendim E.nr.1091/12, të dt.10.08.2012, ka lejuar përmbarimin
ndaj të paditurit si debitor, i padituri në aktvendim mbi lejimin e përmbarimit në afatin e
paraparë ligjor me dt.30.03.2012, ka parashtruar kundërshtim duke theksuar se borxhi i
faturuar është i pasaktë dhe se i njëjti është parashkruar

Përfaqësuesi i paditëses në seancën gjyqësore të mbajtur me dt.25.08.2015 ka
propozuar që të mbahet seance pa prezencën e të paditurit sipas nenit 423.4 të LPK_së
pasi që i padituri ka qenë i njoftuar në mënyrë të rregullt përmes fletëkthesës së
dt.05.08.2015.

Në seancën e mbajtur përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se mbetet në tërësi pran
padi së dhe kërkesë padisë për përmbushjen e obligimit – pagesës së borxhit të provuar
me faturën nr.DFE [REDACTED] të dt.25.08.2012, në emër të shpenzimeve të cilat i ka krijuar
gjatë shfrytëzimit të energjisë elektrike i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesë

padia dhe të obligohet i padituri që në emër të borxhit paditëses t'i paguaj shumën e përgjithshme prej 6.667,36 €.

Kurse sa I përket parashkrimit me të cilin është thirrur I padituri-debitori në kundërshtim ka theksuar se në rastin konkretë nuk kemi të bëjmë me parashkrim, pasi që I padituri ka bërë pagesa të energjisë elektrike nga data 05.07.2011, të cilat pagesa vazhdon të kryej edhe më tutje, ku dhe është ndërprerë parashkrimi

Ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestuese që ka të bëj me taksa gjyqësore për padi dhe aktgjykim.

I padituri në seancën e datës 25.08.2015, ka munguar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flet kthesa e Gjykatës ku ftesën, e ka pranuar me datë 05.08.2015, shtyrjen nuk e ka kërkuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj Gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

I padituri në kundërshtimin e paraqitur kundër aktvendimit për përmbarim ka thekuar se borzhi I faturuar nuk është I sakt duke theksuar se edhe i njejtë është parashkruar, I ka propozuar gjykatës që të padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta rfuzon sit ë pabazar.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: Lexohet Propozimi për ekzekutim që tani konsiderohet padi i dt.17.07.2012, Faturën DFE [REDAKTUAR], e dates 20.05.2012, kundërshtimi i të paditurit i dt.30.03.2012, transaksioni në për të paditurin DFE [REDAKTUAR] autorizimi i paditëses dhënë përfaqësuesit [REDAKTUAR]

Gjykata pas vlersimit të provave të administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruara konstatoi se ekziston detyrimi i të paditurit që paditëses t'i paguajë borxhin në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, meqë i padituri me kurrfarë prove nuk argumentoi të kundërtën, se shumat e faturuara i ka paguar paditëses apo është ngarkuar paushall respektivisht pa bazë ligjore.

Nga provat e administruara u vërtetua se i padituri i ka borxh paditëses shumën prej 6,667.36 €, në emër të shpenzimit të energjisë elektrike e cila vërtetohet edhe me faktin se i padituri me paditësen janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete për shfrytëzim të energjisë elektrike dhe kthimin e borxhit të krijuar në kuptim të nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara–faturat.

Gjykata pretendimin e të paditurit se borxhi i faturuar nuk është real pasi që nuk ka qenë faturuar në mënyrë të rregullt, respektivisht pa bazë, si dhe faktin se kërkesë padia e paditëses është parashkruar i ka refuzuar si të pa bazuar me arsyetim nuk ka mundur me as një prove ta argumentoj se paditësja e ka ngarkuar pa bazë ligjore, kurse pretendimin e të paditurit se borxhi është parashkruar e njëjta është e pa bazuar pasi që i padituri ka kryer pagesa të borxhit energjisë elektrike me të cilat veprime është ndërprerë parashkrimi e duke u bazuar në dispozitave të nenit 378 par.2 të LMD-së.



Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 50 € dhe aktgjykim prej, 20 €, gjithësej në lartësi prej 70 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.471/12 më dt.25.08.2015

Gjyqtari:
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC,

20-10-2015

